



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK  
VENDIM

Nr. 6, Datë 02.02.2022

PËR

MIRATIMIN E RREGULLOREVE DHE KRITEREVE TË KONKURISIT TË  
PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024,  
TË FAKULTETIT TË MUZIKËS NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në zbatim të, Nenit 38-Funksionet e Senatit Akademik, *e vijim* - të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”, shkresës Nr.14 prot., datë 21.01.2022 si dhe shkresës Nr. 13 prot., datë 21.01.2022, të Fakultetit të Muzikës, Senati Akademik i UART, pasi diskutoi mbi “Rregulloret dhe Kriteret e konkursit të pranimit për vitin akademik 2023-2024, të Fakultetit të Muzikës, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë “Bachelor” dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”/”Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” relatuuar nga Dekani i FM, Prof. Dr. Isak Shehu,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Rregulloreve dhe Kriteret të konkursit të pranimit për vitin akademik 2023-2024, të Fakultetit të Muzikës, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë “Bachelor” dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”/”Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”.  
Bashkëlidhur, Rregullorja dhe kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të parë me kohë të plotë “Bachelor” si dhe Rregullorja dhe Kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”/”Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, të Fakultetit të Muzikës.
2. Rregulloret dhe kriteret e konkursit të dërgohen zyrtarisht në MAS, në QSHA si dhe të përditësohen në portalin U-ALBANIA.
3. Ky Vendim, të publikohet në faqen zyrtare të UART sëbashku me rregulloret dhe kriteret e konkurseve të pranimit të miratuara për vitin akademik 2023-2024 të Fakultetit të Muzikës.

**Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.**





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHIHU

Prof. Petrit MAIAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

